REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PRISHTINËS-OPŠTINA PRIŠTINA
26-06-2023
AH-050/01-132524/23
991

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Kryeqyteti Prishtina**
**Opština Priština -Capitol Prishtina**

PRISHTINA

**- Plani i veprimit i menaxhmentit-**

**Për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim për vitin 2022**

| Nr | Kategoria | Komponenta e Auditimit (të gjeturat) | Rekomandimet | Veprimi i menaxhmentit (Drejtorisë) | Data e planifikuar për përfundim | Drejtoria/Zyrtari përgjegjës |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A1 | **Inicimi i projektit në fushën e Teknologjisë së Informacionit pa pëlqimin paraprak të ASHI** Rregullorja nr. 06/2018 për menaxhimin e projekteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, përcakton standardet dhe rregullat për inicimin, planifikimin, ekzekutimin, monitorimin dhe kontrollin për menaxhimin e projekteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Në nenin 6 | Kryetari duhet të sigurojë që, para investimeve në projektet e teknologjisë së informacionit të marrë pëlqimin nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Po ashtu, të shtojë kontrollet e brendshme lidhur memenaxhimin e projektit në vazhdimësi. | Tani e tutje çdo projekt që ka të bejë me teknologjinë e informacionin do të kërkojmë miratim(pëlqim) nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit. Projekti në fjalë është përmbyllur dhe nuk do të këtë më vazhdimësi. | Implementuar. | Besiana Musmurati |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | përcaktohet që, për inicimin e projektit institucionet marrin pëlqimin paraprak nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI). Komuna kishte lidhur kontratë të negociuar për "Implementimin e platformës online për digjitalizim të shkollave", në shumën totale për vit 174,000€, përkatësisht 14,500€ për muaj, platoformë e cila është krijuar paraprakisht nga i njëjti operator ekonomik. Për këtë shërbim, Komuna ka pasur edhe dy kontrata paraprake gjatë vitit 2020 dhe 2021, ku kontrata e parë është lidhur në kohëzgjatjen prej pesë muajsh në shumën 41,500€, ndërkaq kontrata e dytë është lidhur për tetë muaj në vlerë prej 87,760€. Mirëpo, Komuna nuk kishte marrë pëlqimin paraprak nga ASHI për inicimin e projektit, kërkesë kjo e Rregullores për menaxhimin e projekteve në fushën e Teknologjisë së Informacionit. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Për veç kësaj, platforma nuk ishte funksionale që nga dhjetori 2022, për shkak të skadimit të kontratës me Operatorin Ekonomik (OE). Për më tepër, kodi burimor i platformës është në pronësi të OE. Sipas zyrtarëve të Komunës, kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së njohurisë për kërkesat të tilla.Prandaj, kjo tregon edhe mungesë të kontrollit nga Komuna, për procesin që nga inicimi i projektit, poashtu, edhe në menaxhimin e platformës së kontraktuar, në mënyrë që kjo të jetë në funksion të vazhdueshëm. | | | | |
| 2 | A2 | **Furnizimi i punonjësve me pako ushqimore jo në përputhje me ligjin e buxhetit**<br><br>Ligji nr. 08 /L- 066 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës, në neni 12.6 përcakton që, shpenzimi i parave publike nga | Kryetari duhet të sigurojë që, shpenzimi i parasë publike të jetë në përputhje me ligjin për ndarjet buxhetore të vitit përkatës. | Për vitin 2023 dhe vitet e ardhshme nuk do të ketë furnizime të tilla. Prandaj kjo e gjetur nuk do të përseritet më. | Implementuar. | Përparim Rama<br>Valbona Makolli |

**Zyra e Kryetarit të Kryeqytetit**
*Tel.+381 (0) 230 900; e-mail: Perparimrama@rks-gov.net*
*Adresa: Kabineti i Kryetarit të Kryeqytetit, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK*
*10 000, Kryeqyteti Prishtina, Republika e Kosovës*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtime jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës.<br>Komuna kishte lidhur kontratë me dy operator ekonomik për "Furnizimin me artikuj ushqimor për punëtorët e Komunës së Prishtinës", në shumat 222,500€ dhe 223,500€ përkatësisht, ose në total 446,000€. Përfitues sipas Vendimit ishin zyrtarët e administratës së Komunës, të emëruarit politik dhe asamblistët e Kuvendit, me shumë 500€ për punonjës.<br>Komuna ka pohuar se, vendimi për furnzim me pako ushqimore ishte marr për shkak të rritjes së çmimeve dhe inflacionit. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | A3 | **Pagesa për punët/shërbimet me kontratë të skaduar**<br>Sipas kushteve të kontratës "Në shtëpi", e lidhur në mes Komunës dhe Ndërmarrjes Lokale Publike (NLP) "Hortikultura", e datës 19.10.2022 janë paraparë kushtet rreth mirëmbajtjes si dhe çmimet për shërbime.<br>Edhe përkundër përfundimit të kontratës më datën 31.07.2022, Komuna kishte vazhduar për muajin gusht të pranoj shërbime dhe kryerjen e punëve nga NLP. Këto shërbime dhe punë janë paguar sipas kontratës së re të datës 19.10.2022.<br>Sipas analizës së dy pozicioneve të paguara sipas kontratës së re, Komuna kishte paguar më tepër për 50,955€, se sa çmimet në kontratën paraprake.<br>Nuk kishte ndonjë dëshmi se si kishin ardhur deri te negocimi i çmimeve të reja, dhe një praktikë e tillë e pagesës së | Kryetari duhet të sigurojë se kontratat lidhen në kohën e duhur, faturimi dhe pranimi i punëve si dhe pagesa për këto bëhen sipas çmimeve të kontraktuara për periudhën përkatëse dhe jo në mënyrë retroaktive. | Kryetari se bashku me drejtorinë e Parqeve dhe drejtoritë tjera do sigurojë që tani e tutje pagesat të bëhën sipas kontratës së bërë dhe në kohen kur kryhen punimet apo shërbimet. Do të ketë kontrollë të shtuar që pagesat mos të behen në mënyrë retroaktive. | Nëntor 2023. | Përparim Rama<br>Donika Cetta |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | punëve/shërbimeve në mënyrë retroaktive, nuk është e përcaktuar në kontratë.<br>Kjo ka ndodhur nga mungesa e kontrolleve adekuate të zhvillimit të proceduravepara skadimit të kontratës së mëparshme, dhe me rastin e kontratës së re, nuk janë përcaktuar kushtet mbi përcaktimin e çmimit për shërbimet retroaktive. | | | | |
| 4 | **A4** | **Lidhja e kontratave përmes procedurave jo adekuate të prokurimit**<br><br>Neni 35 i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) përcakton që procedura e negociuar mund të përdoret për ushtrimin e aktiviteteve të prokurimit që kanë për qëllim dhënien e: çfarëdo kontrate publike: (iii) nëse, për aq sa është shumë e nevojshme për arsye të emergjencave ekstreme që janë shkaktuar nga ngjarje objektivisht të verifikueshme të cilat nuk kanë pasur | Kryetari duhet të sigurojë, aplikimin e procedurave të hapura të prokurimit duke rritur konkurrencën, në mënyrë që kontraktimi i mallrave/ shërbimeve të bëhet me çmime dhe cilësi sipas kushteve të tregut. | Zyra e Prokurimit me datën 08.06.2023 ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me procedure te hapur per projektin me titull: Sigurimi fizik i objekteve te QKMF-së dhe QMU-se, për periudhen kohore prej 12 muajve.<br>AK Komuna e Prishtinës qe nga viti 2019 ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit per projektin me titull: Sigurimi fizik i objekteve te Komunës.<br>Pas vlerësimit te ofertave dhe përfundimit te lëndes ne | 14.06.2023 | Visar Shehu |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mundësi të parashikohen me arsye nga autoriteti përkatës kontraktues, autoriteti i tillë kontraktues nuk mund ta japë kohën e kërkuar për ushtrimin e cilësdo procedurë tjetër që parashtrohet në këtë ligj.<br>Me kusht që kjo dispozitë të mos mund të shfrytëzohet nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t'u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues.<br>Lidhur me këtë kemi identifikuar si në vijim:<br>• Komuna, në vitin 2022, kishte filluar procedurën e aktivitetit të prokurimit "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të QKMF-së dhe QMU-së", me nr. të prokurimit 616-22-3840-2-1-1, për të cilën një OE kishte ushtruar ankesë në procedurë, | | OSHP-ankese dhe marrjes se shtate (7) vendimeve nga OSHP dhe vete AK procesi eshte i pa zgjidhur. AK Komuna e Prishtines deri me 31.07.2023 do te merr nje vendim per nënshkrimin e kontratës apo per inicim te aktivitetit te ri me procedurë te hapur për Sigurimin fizik te objekteve te komunës.<br>Zyra e prokurimit me datën 13.06.2023 ka pranuar vendimin nga OSHP: 2023/0173 sipas te cilit vendim anulohet aktiviteti i prokurimit për Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës, aktivitet i inicuar në vitin 2021. Komuna e Prishtinës pas pranimit te ketij aktiviteti do te inicon aktivitet per sherbimet e njejta me procedurë te hapur. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).<br>Mirëpo, Bordi i OSHP-së, në korrik të vitit 2022, merr Vendim për hudhje si jashtë afatit për shqyrtim të ankesës së OE.<br>Përkundër që aktiviteti i prokurimit nuk ishte anuluar nga OSHP-ja, Komuna, me arsyetimin se kishte vonesa në shqyrtimin e lëndës dhe skadimit të kontratës paraprake, në korrik të vitit 2022 kishte filluar një aktivitet të ri "Sigurimi i objekteve të Komunës së Prishtinës dhe objekteve të QKMF-së dhe QMU-së, me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me nr. prokurimi 616-22-6436-2-1-5.<br>Për këtë aktivitet ka bërë ftesë për dy OE, ku rezultati i aktivitetit të prokurimit për Lot 1: "Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Prishtinës" ishte nënshkruar kontrata për 399,531€ dhe Lot 2: | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | "Sigurimi fizik i objekteve të QKMF dhe QMU" për 264,435€.<br>• Komuna e Prishtinës, në vitin 2022, kishte kryer dy aktivitete të ndryshme të prokurimit për "Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për Komunën e Prishtinës", me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, me nr. prokurimi 616-22-4-225 dhe 616-22-6139-225, përkatësisht, e jo me procedurë të hapur..<br>Sipas zyrtarëve të Komunës, mangësitë e identifikuara më lartë kanë ndodhur për shkak të vonesave të ndodhura në procedurat e hapura të prokurimit. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | A5 | **Ndarje jo e duhur e detyrave në procesin e vlerësimit për subvencionimin e Fermerëve**<br><br>Sipa RRUOPP, në nenin 62.4 përcaktohet se, një zyrtar nga një departament i cili ka përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencës, ose ka përcaktuar standardet e cilësisë, ose vizatimet e përgatitura nuk mund të marrë pjesë edhe si anëtar i komisionit të vlerësimit, si dhe një anëtar i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si Menaxher i projektit.<br>Për kontratën ''Furnizimi me mekanizma bujqësor për fermer të Komunës së Prishtinës'', në vlerë prej 96,880€, i njëjti zyrtar ishte anëtar i komisionit për vlerësim dhe i komisionit për mbikëqyrje të kontratës. Për më tepër, mbikëqyrësi për realizimin e kontratës, ishte përfitues i një pajisje bujqësore | Kryetari duhet të sigurojë se do ketë ndarje të duhur të detyrave me rastin e procesit të vlerësimit për subvencionimin e fermerëve. Zyrtarët që kanë përgatitur specifikimet dhe/ose termat e referencave të mos janë pjesë e komisionit në vlerësimin e përfituesve dhe të menaxhoj mbikëqyrjen e kontratës duke shmangur çfarëdo konflikti të mundshëm. | Drejtoria e Bujqësisë do të përkujdeset që në propozimin e zyrtarëve për vlerësimin e aplikacioneve të përfitueseve të subvencioneve të jenë kompetent dhe profesional.<br><br>Poashtu do të ndërmarrim masa për secilin rast që të shmangim konfliktin e mundshëm të interesit. | Nëntor 2023 | Plator Gërdovci |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | "Laktrofiz" me kapacitet 500L.<br>Sipas zyrtareve komunal kjo ka ndodhur duke mos e konsideruar si konflikt interesi apo jo e kundërligjshme. | | | | |
| 6 | B1 | **Prezantim i pasaktë i llogarive të arkëtueshme**<br>Gjetja Në nenin 16 të Rregullores MF – nr. | Kryetari duhet të sigurojë se, shpalosjet e llogarive të arkëtueshme në pasqyrat vjetore financiare të jenë të plota dhe të sakta. | D.F ashtu si i raportojnë drejtoritë LLA, do t'i shpalosim në pasqyrat fianciare. | 30.01.2024 | Valbona Makolli<br>Krenar Xhaferi<br>Arbër Sadiki |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 01/2017, për raportim vjetor financiar për Organizata Buxhetore, është përcaktuar që OB-të që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të plotë për shumat e pa arkëtuara.<br>Të arkëtueshmet nga taksat e infrastrukturës, të prezantuara në Raportin dhe Aneksin të llogarive të arkëtueshme, ishin prezantuar në shumën 3,955,946€, shumë kjo e mbivlerësuar për 98,078€, si pasojë e dyfishimit të shumave për dy klientë.<br>Përveç kësaj, të arkëtueshmet nga lejet e ndërtimit, për shkak të gabimeve teknike ishin nënvlerësuar për 250,309€.<br>Mungesa e kontrolleve adekuate, në rastin e hartimit të listës së të arkëtueshmeve, është shkaku i mbivlerësimit/ nënvlerësimit të llogarive të arkëtueshme. | | Vitin 2022 dhe vitet paraparake DIKMK nuk ka pasur ekonomist deri ne muajin shtator 2022, andaj secili zyrtar/ bartës i lendësështeëmarre edhe me çështjet financiare, duke shkatuar vonesë ne përpilimin e këtyre listave.<br><br>DIKMK tani ka plotësuar pozitën e ekonomistit, eshte caktuar nje zyrtar për financa i cili do te merret me çështjet financiare. | | |
| 7 | B2 | **Mos prezantimi i saktë i detyrimeve kontigjente në raportin vjetor financiar** | Kryetari duhet të sigurojë, se detyrimet kontigjente të shpalosura në raportin | Zyra Ligjore ka caktuar një person përgjegjes e cila do të merret nga | 31 Janar 2024 | Arben Kqira |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Rregullorja nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar, në nenin 18, përcakton që OB-të në harmoni me LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente në raportin vjetor financiar.<br>Detyrimet kontigjente nuk ishin prezantuar saktë në raportin vjetor financiar.<br>Si pasojë e dyfishimeve ato ishin mbivlerësuar për 11,847,843€.<br>Sipas përgjigjes zyrtare, kjo ka ndodhur për shkak të veprimeve të ndryshme procedurale vit pas viti, e për pasojë rezulton se në raste të caktuara mund të jenë dyfishuar detyrimet. | vjetor financiar, duhet të jenë të plota, pavarësisht se në cilën fazë të shqyrtimit nga autoritet përkatëse janë ato, deri në marrjen e një vendimi final nga organet kompetente. | fillimi i një detyrimi kontingjent e deri në përfundim të tij.<br>Do të krijohet një databazë e cila do të përmbajë të gjitha dhënat nga momenti i krijimit të detyrimit kontingjent e deri te vendimi i formës së prerë(ekzekutushme).<br>Cdo tre mujor do të paraqitet nga një raport i detyrimeve kontigjente në Drejtorinë e Financave. | | Rina Govori |
| 8 | B3 | **Tejkalimi i furnizimeve të sasive të përcaktuara në kontratë**<br>Gjetja Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik (UOPP), përkatësisht Neni 56.15 përcakton, "Kurdo që Autoriteti Kontraktues (AK) nuk dinë sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të | Kryetari duhet të sigurojë që kontratat publike kornizë zbatohen sipas kushteve dhe çmimeve kontraktuale. Në rastet kur paraqiten nevojat për amandamentim të kontratës publike, ajo të bëhet në përputhje me kërkesat ligjore, rregullën dhe udhëzuesin për prokurimin publik, duke mos tejkaluar | Pas nënshkrimit te kontratës, te gjitha detyrat dhe përgjegjësitë kalojnë tek njësia e kërkesës – menaxheri i kontratës. Pra tejkalimi i sasive te përcaktuara ne kontrate eshte detyre dhe përgjegjësi e menaxherit te kontratës.<br>Zyra e prokurimit te Komunes se Prishtinës, | 14.06.2023 | Visar Shehu |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. Ne këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi". Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë.<br>Raste të tilla për mos zbatim të këtij kriteri ishin si në vijim:<br>• Për kontratën "Mirëmbajtja dhe ndërtimi i kanalizimit në Komunën e Prishtinës", me çmim për njësi 9.73€ dhe vlerë totale indikative të | pragun e lejuar prej 30%. | ne te ardhmen do te kujdeset qe sa me pak te inicoj aktivitete me paramase qe përmbajnë sasi me njësi. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kontratës në shumë prej 400,000€, kishte pasur tejkalim të kontratës për 119,529€ ose 30%. Sipas pikës 3.2 të kushteve të kontratës thuhet se e vetmja pagesë që duhet të paguhet është sipas kontratës publike. Kontrata ishte lidhur sipas çmimit për njesi;<br>• Për kontratën "Ndërtimi i urave", me çmim për njësi me vlerë indikative 350,000€, vlera totale e pagesave ishte 402,269€ apo 15% më e madhe se vlera e parashikuar;<br>• Për kontratën kornizë "Furnizimi dhe rregullimi i oborreve", kishte tejkalim të sasive në 15 artikujt e pranuar në raport me specifikacionin financiar të kontratës. Shuma e tejkaluar për 15 artikujt e pranuar ishte 13,668€. Kontrata ishte e lidhur sipas sasive | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | indikative. Mirëpo, kjo nuk është në përputhje me nenin 56.10 të UOPP, që percakton se mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes se pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.<br>Kjo kishte ndodhur si rezulat i kontrolleve të brendshme jo efikase në procesin e planifikimit të drejtë të paramasës për artikuj, respektivisht vlerësimit të drejtë të nevojave për furnizim me artikuj.<br>11 | | | | |
| 9 | B4 | **Angazhimet e punonjësve me kontrata për punë dhe detyra specifike jo në përputhje me kërkesat ligjore**<br><br>Ligji i punës nr. 03/L – 212, në nenin 8, përcakton që punëdhënësi në | Kryetari duhet të sigurojë se angazhimi i punonjësve përmes kontratave për punë dhe detyra specifike të aplikohet vetëm në rastet për punë dhe detyra që kanë natyrë të veçantë, e jo për pozita të rregullta të punës. Afati kohor i llojit të tillë të kontratave të | Kryetari dhe Burimet Njerëzore do të sigurojnë që për gjatë vitit 2023 do të rishikojnë që asnjë kontratë të mos me e gjatë se 120 ditë dhe të jenë për punë dhe detyra të karakterit të veçantë. | Dhjetor 2023 | Përparim Rama<br>Fadil Aliu |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | sektorin publik është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie pune. Ndërsa në nenin 10.6 përcaktohet që, kontrata për punë dhe detyra specifike nuk mund të jetë më e gjatë se 120 ditë brenda një viti.<br>Komuna gjatë vitit kishte angazhuar 206 punonjës, përmes kontratave për punë dhe detyra specifike, nga të cilët për 194 punonjës pa aplikuar procedura të rregullta të rekrutimit. Pas skadimit të kontratave të para katër mujore, janë përsëritur vazhdimisht kontratat e radhës me nga katër muaj deri më tre herë të përsëritura.<br>Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme, lidhur me angazhimin e punonjësve me shërbime të veçanta dhe kërkesave në zbatimin e ligjit të punës | mos tejkalojë 120 ditë brenda një viti. | Do të këtë kontrolle të brendshme për gjithë të cilët do të angazhohen me shërbime të veçanta. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | B5 | **Vonesa në shqyrtimin e kërkesave për dhënien e lejeve të ndërtimit dhe lejeve mjedisore**<br>Gjetja Ligji i Ndërtimit nr. 04/L-110, në nenin 17 pika 1.2, përcakton që "Leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda 30 ditëve pas pranimit të kërkesës për leje ndërtimore për kategorinë I dhe 45 ditë për kategoritë II dhe III". Po ashtu, sipas nenit 11 të UA nr. 01- 2017- për dhënien e lejeve mjedisore komunale: "Vendimi për miratim ose refuzim të LMK-se i nënshkruar nga Drejtori i Drejtorisë përkatëse, lëshohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës".<br>Komuna nuk kishte respektuar afatet ligjore për lëshimin e lejeve të ndërtimit. Janë identifikuar vonesa në shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi për 175 raste, prej një muaj deri 26 muaj. Për më tepër, vonesa | Kryetari duhet sigurojë se kërkesat për leje ndërtimore dhe mjedisit të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara ligjore. Të analizohen rastet e mungesave të kapaciteteve njerëzore dhe të shqyrtohen mundësit për zgjidhjen e kësaj çështje. | Drejtoria e Urbanizmit do të përkujdeset që Leje ndertimore dhe ato të mjedisit të shqyrtohen brenda afateve të parapara ligjore.<br>Poashtu do të angazhgojë stafë shtesë në mënyrë që të ndihmojë në arritjen e zbatimit të afateve ligjore. | Dhejtor 2023 | Arbër Sadiki |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kishte edhe në lëshimin e lejeve mjedisore deri në 13 muaj.<br>Sipas zyrtarëve kjo ka ndodhur si pasojë e numrit të lartë të kërkesave dhe mungesës së kapaciteteve njerëzore brenda drejtorisë së planifikimit strategjik (e sidomos sektori për lëshimi e lejeve mjedisore komunale) dhe drejtorisë së urbanizmit për shqyrtimin e kërkesave me kohë. | | | | |
| 11 | B6 | **Shfrytëzimi i pronave publike pa kompensim dhe me kontrata të skaduara**<br><br>Ligji për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-040, në nenin 14, përcakton që komunat kanë të drejtë të japin me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme.<br>Komuna kishte bërë verifikimin e pronave komunale në "Zonën Industriale", ku në këtë zonë shfrytëzohen 13 parcela të Komunës me rreth 9.4 ha, nga | Kryetari duhet ti përmbahet zotimeve sipas planit të veprimit të përgatitur nga vet komuna që çështja e këtyre pronave të zgjidhet duke përdor të gjitha mundësit ligjore. Të siguroj se pronat komunale shfrytëzohen vetëm përmes kontratave valide, dhe marrjen e veprimeve konkrete në inkasimin e të hyrave. | Kryetari i Komunes se Prishtines ka marre raportet e Komisioneve te pavarura te cilat kane dal me gjetjet dhe rekomandimet sa i perket Zones Industriale dhe Banesave te Komunes.<br><br>Keto raporte jane diskutuar ne nje seance te jashtezakonshme nga Asambleja e Komunes se Prishtines, e mbajtur me date 05.05.2023 dhe tashme ka mbetur vetem vendimmarrja e Asamblese sipas | Në proces të implantimin.<br><br>Tetor do të implementohen tërësisht. | Përparim Rama Doruntinë Maloku |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 39 biznese private pa asnjë kompenzim ndaj Komunës, duke shkaktuar humbje financiare për buxhetin e Komunës.<br>Për më tepër, Kuvendi Komunal, në vitin 2007, kishte marrë vendim për dhënie me qira të 21 banesave për ish këshilltarët komunal. Përveç kësaj, në vitin 2008, me vendim të komisionit për çështje banesore, ishin dhënë edhe 22 banesa tjera me qira për punëtorët administrativ. Afati i shfrytëzimit të këtyre banesave ishte për një periudhë 10 vjeçare, përkatësisht deri më 2017/18. Përkundër që kontratat nuk janë vazhduar, qiramarrësit vazhdojnë shfrytëzimin e banesave/pronën publike pa pagesë.<br>Pas ngritjes së kësaj çështje në auditime paraprake, menaxhmenti kishte ndërmarr disa veprime si: themelimin e tri komisioneve për verifikimin e | | rekomandimeve te Komisioneve. (Te bashkengjitur gjeni raportet e Komisioneve).<br><br>Po ashtu, kemi vendosur ne degjim publik draft Rregulloren per Dhenien e pronave komunale ne shfrytezim deri ne 1 vit, çka i mundeson Komunes se Prishtines menagjim me te lehte e me te mire te pronave te saj dhe vjelje te rentes nga shfrytezimi i prones komunale. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shfrytëzimit dhe statusit të pronës komunale në zonën industriale;<br>verifikimin e shfrytëzimit të banesave; dhe verifikimin dhe vlerësimin e kontratave të shfrytëzimit të pronës komunale. Komisionet ishin në fazën e hartimit të raporteve mbi punën e kryer.<br>Kjo ka ndodhur për shkak të mos veprimit të menaxhmentit të mëparshëm, për trajtimin e | | | | |
| 12 | B7 | **Dobësitë në procedurat e rekrutimit të personelit në shërbimin civil**<br><br>Rregullorja (QRK) nr. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil, kapitulli II dhe IV, në nenet 40 deri 64, përcaktojnë kushtet dhe kërkesat, komisionet e pranimit dhe aspektet tjera të konkurrimit për pranim, lëvizjet brenda kategorisë dhe ngritjes në detyrë.<br>Për pozitën e punës "Specialist për prokurim publik", njëri anëtar i | Kryetari duhet të sigurojë se përzgjedhja e kandidatëve të bëhet në mënyrë transparente, konkurruese dhe në bazë të meritës. Komisionet e vlerësimit të jenë në përbërje sipas kritereve të përcaktuara, dhe që me rastin e vlerësimit të zbatojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me konkurs. | Sektori i Burimeve Njërëzore do të angazhohet që të gjitha pozitat(konkurset) të cilat do shpallen gjatë vitit 2023 do të jenë trasparente dhe do të behen përmes SIMBNJ.<br><br>Sketroi i Burimeve Njerezore do të zbatoj në përpikmeri rregulloren për procedurat e rekrutimit.<br><br>Komisionet do të jenë në përberje sipas kritereve të parapara dhe do të | Implementuar. | Fadil Aliu |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Komisionit përzgjedhës nuk kishte nënshkruar raportin/renditjen Përfundimtare të kandidatëve. Megjithatë, Burimet njerëzore kishin shpallur fituesin i cili ishte shpërblyer me Akt – emërim, vendimi i të cilit do të bëhej i plotëfuqishëm pas periudhës një vjeçare (sipas Akt – emërimit paragrafi II). Mirëpo, i përzgjedhuri pas pesë ditësh ishte avancuar në ushtrues detyre të Udhëheqësit të sektorit të prokurimit. Për këtë avancim në detyrë, nuk ishte zhvilluar ndonjë proces konkurrues, ku përveç kësaj punonjësi nuk kishte plotësuar kriterin e II-të të akt emërimit.<br>Kjo kishte ndodhur për shkak të mos zbatimit të rregullore për procedurat e rekrutimit, lëvizjes dhe ngitjes në detyrë. | | bejnë vlerësimin sipas ligjit dhe rregullave të parapara. | | |
| 13 | B8 | **Mbajtja e pozitave të punës me ushtrues detyre**<br><br>Ligji nr. 06/L-114 për zyrtarët publik, në nenin 83.10 përcakton që, me | Kryetari duhet të sigurojë që, pozitat e punës të mbajtura me ushtrues të detyrës, të plotësohen me punonjës me kontrata të rregullta të punës. | Të gjitha pozitat ku aktualisht gjenden pozitat U.D do të shpallen dhe përfundojnë gjatë vitin 2023. | Implementuar. | Fadil Aliu |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | hyrjen në fuqi të këtij ligji përbën shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë. Ushtruesit e detyrës (UD) kthehen në vendin e punës. Përkundër kërkesës ligjore për përfundimin e marrëdhënieve të punës me ushtrues të përkohshëm të detyrës, kjo kërkesë ligjore ende nuk ishte zbatuar. Në administratën e Komunës 29 pozita ishin me UD, ndërsa në sektorin e arsimit 36. Përveç kësaj, pozitat e punës shef i sektorit të jashtëm të arkivit komunal dhe udhëheqës i sektorit për menaxhim të kontratave për ndërtim të ulët ishin me UD që nga viti 2016. Për më tepër, drejtorit të një shkolle edhe pas datës së pensionimit i'u kishte vazhduar posti i drejtorit si UD edhe për tre muaj. Kjo kishte ndodhur për shkak që, menaxhmenti nuk kishte arritë që për | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pozitat e mbajtura me UD, të zhvillojë procedura përzgjedhëse për punonjës me kontrata të rregullta. | | | | |
| 14 | B9 | **Vonesa në realizimin e projekteve kapitale**<br><br>Sipas nenit 81 të Ligjit për Prokurim Publik si dhe Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik pika 61.6, 61.19 dhe 61.20, menaxherët e kontratës janë përgjegjës për menaxhimin e kontratës dhe duhet të sigurojnë se, OE kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Secila kontratë publike ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.<br>Për projektet në vijim, punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë, pra kishte vonesa në progresin fizik të tyre:<br>• Projekti "Ndërtimi i rrugëve nëpër fshatra lot-5", vlera e kontratës | Kryetari duhet të sigurojë përmes njësisë kërkuese dhe zyrës së prokurimit se, paramasa dhe parallogaria përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e përformancës të punëve të kërkuara, të përgatiten në pajtueshmëri të plotë me kërkesat sipas projektit/ Derisa, në raste kur kërkohet, problemet pronësore dhe lejet e nevojshme për punimet që do të ekzekutohen, të zgjidhen para nënshkrimit të kontratave. | DIKMK ka marre disa hapa qe gjate vitit 2023 te realizohen projektet sipas planit dinamik;<br>Këtë vit, ne i kemi tenderuar shumicën e projekteve në muajin janar 2023, dhe tani pjesa më e madhe e tyre janë duke u ekzekutuar në terren dhe besojmë fuqishëm se do të kemi një realizim më të madh të projekteve.<br>Gjithashtu kemi rritur nivelin e bashkëpunimit me Drejtorine e Prones, ne menyre qe procedurat e shpronësimit ne ato raste qe ka nevoje per shpronësim te kryhen me shpejte dhe mos te shkaktohen vonesa ne realizimin e projekteve.<br><br>Drejtoria e Sportit ka shtuar kontrollin per te gjitha projektet te cilat | Dhjetor 2023 | Krenar Xhaferi<br>Granit Rugova |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 330,703€, afati për përfundimin e projektit ishte 6 dhjetor 2022, ndërsa deri në fund të vitit progresi fizik ishte në shkallën 41%;<br>• Projekti ''Ndërtimi i rrugëve nëpër fshatra lot-2'', vlera e kontratës 219,404€, afati për përfundimin e projektit 2 nëntor 2022, ndërsa deri në fund të vitit progresi fizik ishte në shkallën 57 %; dhe<br>• Projekti ''Ndërtimi i tribunës lindore në stadiumin 2 korriku'', vlera e<br>kontratës 195,794€, plani dinamik i të cilit ishte 90 ditë, mirëpo ishte<br>paguar vetëm situaconi i parë në shumë prej 87,450€ apo 45% nga<br>shuma e kontratës, dhe ishte ndërprerë kontrata me arsyetim se<br>çmimet janë të larta në treg. Raste të tilla të ndërprerjes së<br>kontratave sipas një raportit të prokurimit ishin edhe për 23 projekte | | janë duke u implementuar dhe projektet te cilat do të fillojnë gjatë vitit 2023. Do të kërkohen raportime me të shpeshta nga menaxheret e kontratave për punën që janë duke e kryer OE-të në terren. | | |

**Zyra e Kryetarit të Kryeqytetit**
Tel. +381 (0) 230 900; e-mail: Perparimrama@rks-gov.net
Adresa: Kabineti i Kryetarit të Kryeqytetit, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK
10 000, Kryeqyteti Prishtina, Republika e Kosovës

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | tjera.<br>Sipas zyrtarëve komunal vonesat në realizimin e projekteve kanë ndodhur si rezultat i kushteve atmosferike, problemeve të shpronësimit si dhe arsyetimit të rritjes së çmimeve në treg për projektet përkatëse. | | | | |
| 15 | B10 | **Pagesat përmes vendimeve gjyqësore/ përmbarimore**<br><br>LMFPP, neni 39, përcakton që Zyrtari Kryesor Financiar i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim. Ndërsa sipas nenit 40 të LMFPP, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhrit të prerë nga gjykata/ përmbaruesi. | Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave monitorojnë dhe sigurojnë se kontratat publike për punë, furnizime dhe shërbime, realizohen sipas kushteve kontraktuale përfshirë edhe pagesat përkatëse. | Do të ketë kontrolla nga menaxheret, ogani mbikëqyrës dhe vet drejtoret e drejtorive per te gjitha kontratat te cilat janë duke u zbatuar.<br><br>Drejtoria e Financave përmes certifikuesve dhe shpenzuesve do te jetë në nivelin me të lartë të kontrollit të secilës pagesë.<br><br>Zyra ligjore do t'i shikojë në mënyrë më rigoroze të vendimet e gjykatave dhe përmbarimit. | 30.01.2024 | Valbona Makolli<br>Arben Kqira |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Komuna kishte paguar 1,546,231€, në emër të kamatave dhe procedurave përmbarimore, si pasojë e pagesave me vendime gjyqësore. Në total pagesat përfshirë borxhin dhe kamatat ishin 6,218,086€, ku për paga dhe mëditje janë paguar 2,154,695€, për mallra dhe shërbime 495,549€, shërbime komunale 1,569€ dhe investime kapitale 3,566,273€.<br>Përveç kësaj, nga analiza e data bazës së furnitorëve, ishin kryer pagesa në shumën mbi 15,000,000€, të cilat e kishin tejkaluar afatin ligjor prej 30 ditëve deri mbi një vit.<br>Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhim të kontratave publike, vonesave në kompletim të lëndëve, paqartësisë ligjore për pagesën e pagave shtesë/ jubilare etj. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 16 | B11 | **Mos përdorimi i programit e-pasuria dhe mos inventarizimi i pasurisë**<br><br>Rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 6, pika 3, përcakton që pasuria jokapitale dhe stoqet duhet të regjistrohen dhe menaxhohen nga programi E-pasuria. Ndërsa, me nenin 18, kërkohet që OB duhet të kontrollojnë së paku një herë në vit pasurinë për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë jo financiarë.<br>Programi e-pasuria nuk përdoret për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë jokapitale dhe stoqeve. Shënimet financiare për pasuritë jokapitale dhe stoqet mbahen në formatin Excel. Kjo formë e regjistrimit të pasurisë nuk ofron siguri për plotësinë e shënimeve, mund të bëhen gabime apo edhe ndryshime të paautorizuara. | Kryetari duhet të sigurojë se pasuritë jokapitale dhe stoqet të regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria. Të ndërmerren veprimet e nevojshme në futjen në përdorim të këtij aplikacioni për menaxhimin e pasurisë. Inventarizimi i pasurisë të kryhet para përfundimit të vitit fiskal, me qëllim që të gjitha ndryshimet në vlerën e pasurisë të reflektojnë në raportin vjetor financiar. | Ju njoftojmë se jemi duke punuar për riaktivizimin e sistemit e-Pasuria, deri më tani janë caktuar zyrtarët te cilet do mirren eksluzivisht me futjen e të dhenave të inventarizimit i cili fillimisht duhet vlersuar. Gjithashtu ju njoftojm se për qeshtjen e sistemit e-Pasuria eshte caktuar nga kabineti i Kryetarit z.Muhedin Nushi si koordinator për grupin (zyrtarët) qe do perfshihen. Ne bashkpunim me koordinatorin dhe perfaqesuesen e USAID-it, jemi dakorduar qe, nga fillimi i javes se ardhshme te mirremi me intenzivisht me qeshtjen ne fjale. | 31.12.2023 | Valbona Makolli<br>Bersant Beka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Komuna kishte caktuar komisionin për inventarizimin vjetor të pasurisë publike po jo edhe ndonjë komision për vlerësim të pasurisë. Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare. Përveç, inventarizimit fizik të pasurive komisioni nuk ka përgatitur ndonjë raport përmbledhës lidhur me ndryshimet apo gjendjen e pasurive jo financiare. Sipas shpjegimeve të zyrtarëve komunal, kjo ka ndodhë për shkak të problemeve teknike në funksionimin e këtij programi. Po ashtu mos harmonizimi i shënimeve kontabël me gjendjen faktike ka ndodhur për shkak të neglizhencës së zyrtarëve përgjegjës për realizimin e detyrave të përcaktuara me kohë dhe sipas legjislacionit përkatës. | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | B12 | **Menaxhimi i dobët i llogarive të arkëtueshme**<br><br>Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, në nenin 26, përcakton që Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore që kalojnë shumë 10€, ndërsa në nenin 27 përcaktohet se, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën në përputhje me afatet e përcaktuara, Komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda 10 ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se 10 ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. | Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore. | Gjatë vitit 2023 kemi marre disa veprime sipas dispozitave ligjore kemi dërguar 300 letër kujtesa kështu deri ne fund te vitit do i trajtojmë te gjithë tatimpaguesit e madhej te pa përfunduar sipas dispozitave ligjore ku si rezultat deri me tani disa kanë paguar dhe 17 obligues tatimor kane hyr ne marrëveshje pagës me këste.<br>Deri ne funde te vitit do përpiqemi që brenda kapaciteteve qe kemi te trajtojmë sa me shume raste dhe ti bindim tatimpaguesit qe te shlyej obligimet.<br>Do iniciojnë rastet ne përmbarim për te gjithë ata qe nuk i përgjigjen pozitivisht për kryerje obligimeve apo nuk i përmbahen marrëveshjes. | 31.Dhjetor. 2023 | Përpraim Rama Valbona Makolli |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Llogaritë e arkëtueshme janë 69,220,102€, nga të cilat 41,340,680€ ose 60% e tyre janë për tatimin në pronë. Për më tepër, mbi 5,200,000€ është rritja e të arkëtueshmeve në krahasim me vitin paraprak, dhe kjo shumë e lartë e të arkëtueshmeve po përcillet ndër vite.<br>Menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme në inkasim me kohë të të hyrave nga tatimpaguesit.<br>Mungesa e kontrolleve adekuate në menaxhim dhe inkasim të të hyrave ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme. | | | | |

**Zyra e Kryetarit të Kryeqytetit**
*Tel. +381 (0) 230 900; e-mail: Perparimrama@rks-gov.net*
*Adresa: Kabineti i Kryetarit të Kryeqytetit, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK*
*10 000, Kryeqyteti Prishtina, Republika e Kosovës*

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | C1 | **Keqklasifikimi në kategoritë ekonomike**<br><br>Neni 18, paragrafi 3, i Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parasë publike", përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.<br>Si rezultat i planifikimeve buxhetore në kategoritë jo përkatëse, nga buxheti për investime kapitale janë paguar 2,453,137€ shpenzime që për nga natyra nuk i takojnë investimeve kapitale, e që kryesisht kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe gjelbërimin e hapësirave publike, sinjalizimet rrugore,<br>pastrimi i lumenjëve etj.<br>Kjo ka ndodhur për shkak të planifikimeve buxhetore në kategoritë jo adekuate ekonomike, dhe mos pagesës së shpenzimeve nga buxheti i kategorisë përkatëse. | Kryetari duhet të sigurojë se buxheti vjetor planifikohet në kategoritë përkatëse ekonomike, më tutje të sigurohet se të gjitha shpenzimet janë klasifikuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë në raportimet financiare. | Kjo e gjetur është e mbyllur për buxhetin e vitit 2023 sespe nuk ka keqklasifikim te kategorive ekonomike. | Implementuar. | Përparim Rama<br>Valbona Makolli |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | C2 | **Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi në pronë**<br><br>Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11.1 përcakton se, personi fizik i cili vendos se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor (për të cilën e deklaron në Komunë), i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit.<br>Përveç kësaj, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/ apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni. | Kryetari të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunal dhe Ministrisë së Financave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual. | Lidhur me banim parësor zyra e tatimit ne prone ka marre masa që ti korrigjoj te gjitha rastet te cilat kane ma tepër se një njësi për banim primar nga zbritja parësore mirëpo kemi vrejtur edhe mos përputhje me te gjeturat ku si rezultat kemi disa mostra qe kemi dërguar ne DTP – MFPT , për korrigjim te raporteve me dt. 05.05.2023 ku kemi vrenjtur gabime ne raportin qe gjen eron sistemi i tatimit ne prone<br>P sh -Ne raport financiar ka raste ku zbritjen figuron qe kanë përfituar 3 njësi për te njëjtin TP kurse ne STP i njëjti TP dhe njësit e bashkangjitura nuk kanë përfitim fare.<br>Jemi duke analizuar te gjitha rastet dhe do i adresojnë ne DTP – MFPT . | 31.Dhjetor .2023 | Valbona Makolli<br>Milaim Krasniqi |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Pas analizës së bërë, në lidhje me zbatimin e zbritjes së lejuar për vendbanimin parësor dhe zbatimit të Vendimit për regjistrimin e numrit personal, janë identifikuar mangësitë si në vijim:<br>Për 7,958 tatimpagues, është zbatuar zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit, duke u mbështetur në nenin 11 – "Zbritjet për vendabanim parësor", mirëpo kjo zbritje është bërë për pronat e personave për të cilët nuk ishte evidentuar numri personal, ku për pasojë rezulton më pak të hyra nga tatimi në pronë për rreth 179,055€.<br>Përveç kësaj, zbritja primare ishte zbatuar ndaj 602 tatimpaguesve, të cilët kanë në posedim prona rezidenciale më shumë se një pronë, zbritje e cila rezulton më pakë të hyra nga tatimi në pronë për rreth 13,545€.<br>Sipas konfirmimeve zyrtare, kjo çështje ishte bartur nga vitet paraprake, | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | mirëpo për faturimet e vitit 2022, për tatimpaguesit që nuk kanë numër personal të evidentuar dhe të cilët nuk e kanë deklaruar "Banimin Parësor" nuk do të zbatohet zbritja e lejuar. | | | | |
| 20 | C3 | Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike<br>Gjetja Sipas nenit 2.1 të Rregullores MF-nr. 04/2017 – Mbi kriteret, standardet e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) parashihet që, financimi i projekteve dhe programeve të OJQ-ve bëhet sipas një thirrje publike, dhe të cilat i plotësojnë kriteret e Rregullores. Ndërsa në nenin 6 | Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit të OJQ-ve, respektohen kërkesat e Rregullores, ashtu që mbështetja financiare të bëhet me thirrje publike sipas kritereve të përcaktuara. Po ashtu, të kërkohen raporte kthyese financiare dhe narrative nga përfituesit. | Në bazë të thirrjeve dhe shpalljeve publike në si dejtori sigurohemi që t'i pembahmi nenit 6 pika 6.2 te rregullores komunale se përfituesit fizik apo juridik mund te perfitojnë subvencione vetëm një herë mbrenda vitit mirëpo nuk e përjashtojmë mundësinë eksplicite që ndonjë iniciative vjen nga kabineti, Sqarim: (vitin e kaluar kemi pasur rastin me Odesa festival që | Dhjetor 2023 | Përparim Rama<br>Arta Balaj<br>Granit Rugova |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pika 6.2 e Rregullores së Komunës përcaktohet, se përfituesit fizik apo juridik mund të përfitojnë subvencione vetëm një herë brenda vitit.<br>Bazuar në testet e kryera rezulton se, katër OJQ fituese të subvencioneve (për sport, kulturë dhe organizatë komunale e pensionistëve), janë përzgjedhur në bazë të Vendimeve të Kuvendit Komunal, pa shpallje paraprake të thirrjes publike. Shuma e përfituar e këtyre katër përfituesve të subvencioneve ishte 143,000€. Për më tepër, për një OJQ përfituese ishin ndarë tri herë subvencione brenda vitit, ndërsa për dy OJQ tjera ishin dhënë subvencione dy herë brenda vitit. Përveç kësaj, përfituese ishte edhe për "Kuzhinën qendrore" në vlerë 30,000€, mirëpo përfituesi nuk kishte hartuar raporte kthyese financiare dhe narrative në lidhje me shfrytëzimin e këtyre fondeve. | | është subvencionuar dhe për festivalin Odesa për shakka të luftës ne Ukraninë e kemi mbështetur përmes me Vendim te kuvendit<br><br>Drejtoria e Sportit do të përkujdeset që asnjë përfitues të mos mund të përfitoj dy hërë brenda viti. Për këtë do të shtojmë kontrollin gjatë rasteve të ndarjeve se subenvencioneve. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Kjo ka ndodhur për shkak të mungesave të kontrolleve adekuate për të zbatuar kriteret sipas kërkesave ligjore. | | | | |
| 21 | C4 | **Mungesa e autorizimeve për realizimin e punëve dhe orëve shtesë**<br><br>Gjetja Rregullorja nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera, në nenin 11 përcakton që, nënpunësit civil kanë të drejtë të kompensohen ose të marrin kohë të lirë jashtë orarit, nëse mbikqyrësi i drejtëpërdrejtë paraprakisht ka autorizuar dhe vërtetuar punën jashtë orarit.<br>Nuk është bërë autorizimi paraprak i punës dhe orëve shtesë nga mbikëqyrësi i | Kryetari duhet të sigurojë se, punët shtesë realizohen vetëm nëse paraprakisht janë arsyetuar dhe autorizuar orët e punëve shtesë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, dhe se mbahet evidencë për orët dhe ditët e angazhimeve në punët shtesë. | Shefi i Sektorit i Burimeve Njërzore ka kërkuar nga Kryetari dhe të gjithë drejtoret e drejtovive që të zbatojnë rregullat e parapara që janë të përcatuara për punët shtesë. Poashtu shefi i Sektorit të Burimeve Njëzore ka përcjellur të gjithë formularët që për t'i plotësuar se cili që kërkon orë shtesë.<br>poashtu do të këtë kontrollë me të shtuar sa i përketë orëve shtesë | Dhjetor 2023 | Fadil Aliu |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | drejtpërdrejtë me përjashtim të Inspektoratit të Shërbimeve Publike. Nga lista mujore e kompensimeve të muajit dhjetor 2022, në vlerë totale 27,819€, ku përveç një raporti përmbledhës për pagesë mujore, nuk ishte evidencë analitike që dëshmon se në cilat ditë apo data dhe nga sa orë është punuar jashtë orarit apo gjatë vikendeve. Punët për të cilat janë paguar kompensime shtesë janë punë të cilat pritet të kryhen gjatë orarit të rregullt të punës, siç janë punët lidhur me menaxhimin e personelit dhe aktivitetet e rregullta të procesit te prokurimit. Shkak i kësaj është mungesa e kontrolleve të brendshme në autorizimin dhe mbikëqyrjen e orëve shtesë. | | Sektori i Burimeve Njërzore ka caktuar një person përgjegjës për verifikimin dhe kontrollin e orëve shtesë. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 22 | C5 | **Mungesa e planeve të veprimit dhe niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve**<br><br>Me Rregulloren, procedurat dhe doracakun e auditimit të brendshëm kërkohet nga menaxhmenti që të dorëzojnë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Përgjigjet e menaxhmentit duhet të përfshijnë veprimet specifike që duhet të ndërmerren, personin(nat) përgjegjës për veprimet korrigjuese, orarin dhe kryerjen e tyre dhe rezultatet e pritura.<br>Nga dhjetë raporte të auditimit të brendshëm, vetëm shtatë drejtori kanë përgatitur planet e veprimit për adresim të rekomandimeve. NjAB në raportet e auditimit të brendshëm kishte dhënë 56 rekomandime, dhe nga to ishin zbatuar vetëm 17, ndërsa 31 rekomandime nuk ishin adresuar fare dhe tetë (8) tjera ishin në proces të zbatimit. | Kryetari duhet të sigurojë se, drejtoritë e audituara përgatitin planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve të NjAB-së, dhe ndërmarrin veprime konkrete për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit të brendshëm. | Kryetari në bashkëpunim me U.D. e udhëheqësit të NJAB-së, do të bejnë një rishikim për çdo dy muaj rreth implementimit të rekomandimeve të NJAB-së për drejtoritë ku kryhet auditimi i brendshëm.<br><br>Periudhat e rishikimit do të jenë, më 30 gusht 2023, 30 tetor 2023 dhe 20 dhjetor 2023.<br><br>Poashtu, për secilin raport të auditimit do të hartohet plan i veprimit për implementimin e rekomandimeve.<br><br>Deri më tani janë hartuar 4 plane të veprimit për drejtoritë ku është berë auditim.<br><br>Drejtorinë e Kadastrit, Burimeve njërëzore, Mirëqenie Sociale dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike. | 20 Dhjetor 2023 | Përparim Rama<br>Osman Bllaca |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shkak i kësaj është mungesa e përkushtimit të menaxhmentit dhe njësive të audituara në adresimin dhe përmirësimin e kontrolleve të brendshme. | | | | |

Duke marrë në konsideratë Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA-së), në pajtim me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, jemi zotuar për adresimin e rekomandimeve të dhëna përmes Planit të veprimit.

Kryeqyteti Prishtina,

Më, 20.06.2023

**KRYETAR I KRYETYTETIT**
Përparim Rama

*Zyra e Kryetarit të Kryeqytetit*
*Tel. +381 (0) 230 900; e-mail: Perparimrama@rks-gov.net*
*Adresa: Kabineti i Kryetarit të Kryeqytetit, kati i -të, ndërtesa e vjetër, rruga UCK*
*10 000, Kryeqyteti Prishtina, Republika e Kosovës*